



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 97, Datë 27 / 09 / 2017

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa nr. 54 Regj, datë 03.08.2017, e S. M¹.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²

K O N S T A T O I:

Ankuesja informon Komisionerin³ se: “ *Në familjen time jemi të gjithë të papunë. Kam 6 fëmijë në moshë minorene, jetojmë pa asnjë të ardhur dhe pa ndihmë ekonomike. Kërkoj nga ana e Bashkisë Fier të më përfshijë në listën e përfituesve të ndihmës ekonomike*”.

Raca është një nga shkaqet për të cilat Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi për shkak të racës përbën shkak të mbrojtur nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, i cili parashikon se: “...“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

¹ Ankesa është marrë në kuadër të “Ditëve të hapura”, me komunitetin rom të Lagjes “1 Maji” / Fier, organizuar nga KMD.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

³ Referuar formularit të ankesës sjellë pranë KMD-së.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me anë të shkresës me Nr.756/1 Prot., datë 10.08.2017, Komisioneri ka kërkuar informacione nga ana e Bashkisë Fier, lidhur me ankesën bërë nga znj. M.

Me shkresën me Nr.6512/1 Prot., datë 06.09.2017, nga ana e Bashkisë Fier sqarohet se “...nga takimi i përfaqësuesit të Drejtorisë së Shërbimit Social të Bashkisë dhe punonjësit social të Njesisë Administrative Levan, Bashkia Fier, me dy bashkëshortët M, rezultoi që ato nuk kanë aplikuar asnjëherë për të përfituar ndihmë ekonomike. Gjatë takimit atyre iu rekomandua aplikimi për futjen në skemën e ndihmës ekonomike, por ata u shprehën se do ta bëjnë në një kohë tjetër, pasi kërkojnë të largohen jashtë shtetit tek të afërmit e tyre⁴”.

Duke u bazuar në analizimin e rastit dhe të dhënave të vëna në dispozicion nga palët, **konkludojmë se:**

Bazuar në përgjigjen shkresore sa më sipër, nuk rezulton të ketë diskriminim nga ana e Bashkisë Fier, pasi jemi në situatën kur subjekti ankues nuk është paraqitur fare pranë kësaj Zyre për të aplikuar për përfitimin e ndihmës ekonomike. Për më tepër ankuesja ka refuzuar të aplikojë për futjen në skemën e përfitimit të ndihmës ekonomike, për shkak se do të largoheshin jashtë shtetit. Kjo vërtetuar nga procesverbali i nënshkruar nga vetë ankuesja dhe bashkëshorti i saj.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gerrat a) dhe c), nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminit për shkak të racës, të S. M, nga ana e Bashkisë Fier.
2. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i rekomandon subjektit ankues, të paraqitet pranë Njesisë Administrative Levan/Bashkia Fier, për të aplikuar për përfitimin e ndihmës ekonomike.

⁴ Bashkëlidhur shkresës është dhe një kopje e procesverbalit të mbajtur në ambjentet e Njesisë Administrative Levan/Fier, firmosur nga të dy bashkëshortët dhe punonjësi i kësaj njësie administrative.

3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

Fusha: Shërbime

Shkaku:Raca

Lloji i vendimit: Mosdiskriminim